



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1040 Prot.

Tiranë, më 2.09.2024

VENDIM

Nr. 3, datë 2.09.2024

PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSREKTORIT TË ANËS MËSIMORE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Mbështetur në nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 23, pika 3 dhe në nenin 28, pika 5 të Statutit të Universitetit të Arteve, si dhe në shkresën nr. 1065, datë 02.09.2024 të Rektorit të Universitetit të Arteve, me lëndë: “Mbi emërimin e Zëvendës rektorit të anës mësimore në Universitetin e Arteve”, Senati Akademik i Universitetit të Arteve pasi diskutoi mbi këtë propozim, me votim të hapur dhe unanim,

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit për zgjedhjen e **Prof. Asoc. Dorian ÇENE** Zëvendësrektor të anës mësimore të Universitetit të Arteve.
2. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI**

Nr. 1065 prot.

Tiranë, më 2/03/2024

Lënda: Mbi emërimin e Zëvendës rektorit të anës mësimore në Universitetin e Arteve

**Senatit Akademik
Universiteti i Arteve Tiranë**

Të nderuar anëtarë të Senatit Akademik

Sikurse jeni në dijeni, në mbledhjen e sotshme, sipas rendit të ditës, veç të tjerash, kemi edhe zgjedhjen e zëvendës rektorit të anës mësimore në Universitetin e Arteve.

Për pozicionin e zëvendës rektorit të anës mësimore, në cilësinë e Rektorit, bazuar në Statutin e Universitetit të Arteve, Neni 27, gërma n, të propozoj Prof. asoc. Dorian Çene.

Prof. asoc. Çene ka një karrierë të gjatë si pedagog me kohë të plotë në institucionin tonë prej vitit 2003.

Në vitin 2011 fiton titullin akademik Profesor i Asociuar dhe prej asaj kohe ka qenë titullar i lëndës së Kontrapunktit, Muzikologjisë Sistematike, Etnomuzikologjisë dhe së fundmi Teknikave të Kompozimit Shek. XX.

Është hartues i programeve për lëndët të cilat i ka drejtuar në cilësinë e titullarit. Njëherazi, përpos angazhimit pranë Universitetit të Arteve, ka dhënë mësim edhe në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, sikurse ka mbajtur Master-Class pranë Universitetit të Minnessota-s në SHBA.

Prej vitit 2023 është anëtar i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Jomateriale në Ministrinë e Kulturës (sot MEKI), ndërkohë që ka mbajtur edhe detyrën e lektorit për trajnimet e mbajtura nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me UNESCO-n për inventarizimin e trashëgimisë jomateriale dhe ka drejtuar punën për hartimin e dosjes së Xhubletës në UNESCO.

Në cilësinë e kompozitorit ka krijuar një sërë veprash, kryesisht të muzikës së dhomës, të cilat janë interpretuar brenda dhe jashtë vendit si në Itali, Australi, SHBA, Gjermani, Austri, etj.

Është themelues i shoqatës së Kompozitorëve Shqiptarë, me të cilën organizon një sërë aktivitete për mbështetjen dhe promovimin e krijimtarisë muzikore të kompozitorëve shqiptarë, ndërkohë që prej vitit 2006 e në vazhdim, në cilësinë e drejtuesit artistik organizon

festivalin "Ditët e Muzikës së Re", koncertet e kompozitorëve të rinj, Festivalin Ballkanik të Muzikës Bashkëkohore dhe së fundmi caktohet si pjesë e grupit organizator të Festivalit Kombëtar të Gjyrokastres 2023.

Sikurse jeni në dijeni, ka qenë anëtar i Senatit Akademik të Universitetit të Arteve në periudhën 2020-2024, ndërkohë që është rizgjedhur në këtë detyrë nga stafi akademik i Fakultetit të Muzikës.

Prej vitit 2016-2024 zgjidhet drejtues i departamentit KMDP në Fakultetin e Muzikës, çka, në gjykimin tim, i ka dhënë edhe eksperiencën e duhur përsa i përket administrimit dhe organizimit të veprimtarisë akademike në Institucionet e Arsimit të Lartë dhe sidomos në lidhje me specifikat që ka Universiteti i Arteve Tiranë.

Gjatë kohës që ka drejtuar departamentin KMDP, ka qenë anëtar i grupit të punës për akreditimin institucional të Universitetit të Arteve dhe ka drejtuar punën për akreditimin e të gjitha programeve të ciklit II në departamentin e drejtuar prej tij.

Është hartues i programit të ciklit të tretë doktoratë në "Muzikologji", ndërkohë që së fundmi është angazhuar edhe nga ASCAL në cilësinë e ekspertit për akreditimin dhe kodifikimin e programeve studimore të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga sa më sipër dhe referuar jetëshkrimit të tij të plotë, bashkëngjitur, besoj se Prof. Asoc. Dorian Çene zotëron aftësitë e duhura për realizimin e detyrës së Zëvendës rektorit të anës mësimore.

Me respekt,

REKTOR

Prof. Dr. Erald Bakalli

